

BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër
Viti II i botimit, Nëntor 2008 Nr. 19. Çmimi 20 lekë.
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it


Kryeredaktor Selim Gokaj



MUSLIMANET DUHET TE KERKOJNE NDERTIMIN E XHAMISE NE TIRANE ME TE GJITHA MJETET DEMOKRATIKE

Gazeta "Besimtari" perseri po e trajton problemin shqetesues te ndertimit te nje xhamie te madhe ne Tirane, e cila duhet te plotesoje nevojat e muslimaneve qe ata te mos falen ne rruge ne mes te pluhurit dhe te shiut, por te kene kushte optimale qe te falen mrenda nderteses se kultit, per te shpetuar nga diskreditimi publik qe po u behet nga ata qe kane forcen e ligjit per te dhene leje qe edhe muslimanet ne Tirane te kene nje xhami te madhe si perfaqesuesit e religjonit katolik dhe ortodoks te cilet i kane kishat e tyre, ku njera lartehet ne mes te Tiranës, kurse tjetra po lartehet dhe ajo ne mes te Tiranës dhe nuk dihet deri ku do te arrije ne hapesire kryqi i saj. Ne ditën e faljes se Fiter Bajramit u kerkua nga muslimanet e Tiranës qe te jepet leje per ndertimin e nje xhamie te madhe ne Tirane, sepse ajo tashme nuk eshte nje kerkese luksi as supermacie, por eshte thjeshte nje kerkese, qe duhet te realizohet nga pushteti lokal dhe te mbeshtetet edhe nga pushteti qendror qe te vendoset ne vend nje padrejtesi si shume te tjerave qe po i behet ummetit musliman sot ne Shqiperi. Per ilustrim kujtojmë moskthimin e pronave bashkesise islame nga ata qendra qe manipulojne ligjin dhe pushtetin aktual ne Shqiperi. Po cili eshte kalvari i gjate neper te cilin ka ecur kerkesa per ndertimin e xhamise se madhe ne Tirane?

Fillimet datojne ne vitin 1992, kur ne pushtet ishte Partia Demokratike, kohe ne te cilen fondet per ndertimin e xhamise ishin siguruar dhe siperfaqja e ndertimit ishte ne dispozicion, sepse vete KMSH ishte pronare e kesaj siperfaqeje e cila nuk do te sillte pengese per ata qe do te aprovin lejen per ndertimin e kesaj xhamie. Por, eshte pikerisht ky moment, kur muslimanet u njohen me deklarata-



ten e nje drejtuesi te larte te Partise Demokratike i cili deklaroi se ne nuk e lejojme priftin dhe hoxhen te kendoje tek dera e parlamentit. Ishte e qarte se ketu nuk ishte fjalla per te kenduar prifti, sepse kur desh te kendoje prifti, ate nuk e pengoi kush dhe sot ai kendon me te drejte ne mes te Tiranës nga nje katedrale madheshtore e cila do te mbushet ne te ardhmen pa tjetër me besimtare, sepse sot ajo ka hapesira boshe me shumice. Deklarata e larte e ketij nepunesi ishte nje paralajmerim me qitje te largët, sepse ne shinjester ishte hoxha i cili paralajmerohej, se bashku me besimtare qe e pasonin, se per ata nuk do te kishte xhami te madhe ne Tirane dhe se vetem rruga me pluhur dhe balte do te ishte vendi qe do u rezervohet muslimaneve ne Tirane. Do te kalonin vite dhe stafeten per ta penguar ndertimin e xhamise ne Tirane do ta merrte kryetari i "i perjetshem" i bashkise se Tiranës, Edvin Kristaq Rama qe e koncepton Tiranen vetem me kisha katolike dhe kisha ortodokse, por kurrësi me xhami te madhe per muslimanet. Dhe ai aprovon plane urbanistike per Tiranen

nga me madheshtoret, por gjithmone pa prezencen e xhamise per muslimanet. Nuk dihet sakte si e ndjejn vehten kryetari i shartuar me dy fe, kur i shikon muslimanet duke u falur ne mes te rruges te denuar nga ky kryetar dhe nje kryetar tjetër me i madh qe deklaronte se kete kompetence e ka vetem bashkia e Tiranës, ne nje kohe qe kur e quajti te drejte, e beri cope e therrime mbikalimin tek Zogu i Zi qe ishte ndertuar me lejen e Kryetarit te Bashkise se Tiranës. Koha ka vertetuar se kur eshte kerkuar nje e drejte nga nje individ ose nje grup individesh ata kane zgjedhur pisten me te mundshme per te realizuar kerkesen e tyre. Prandaj, edhe muslimanet si bashkesi dhe institucionet e tyre, duhet te bashkepunojne dhe te kordinojne mendimet dhe veprimet e tyre per t'i detyruar ata qe po i pengojne dhe po i poshterojne ditën per diell, qe t'u japin leje per ndertimin e xhamise. Mendojmë qe ka ardhë momenti qe muslimanet "te tregojne muskujt" duke demonstruar ne shesh per te kerkuar te drejten e tyre per te pase edhe ata nje xhami. Ata duhet te mos frikesohen, sepse de-

mostratat jane mjete demokratike per te kerkuar nje te drejte. Edhe institucionet islame nuk duhet te frikesohen nga penalizimi i mundshem si ekstremiste islamike, sepse kesaj teze tashme i ka dale boja dhe eshte diskredituar perfundimisht. Ne jemi te bindur se me metoda demokratike, ku demonstratat jane me te rendesishmet, muslimanet do ta detyrojne pushtetin lokal dhe ate qendror qe te trajtohen si te barabarte ne kerkesat e tyre me religjonet e tjera sepse, vetem duke u bere faktor puplikisht, muslimanet mund ta shohin vehten duke u falur ne xhami dhe jo duke fshire rruget me rrobat e tyre, kur ato jane duke falur namazin. Eshte e dhimshme kur shikon se edhe ne Kosove muslimanet falen neper rruge me pluhur dhe me balte. Eshte edhe me e dhimshme, kur shikon se edhe ne Maqedoni, besimtare muslimane po e provojne shijen e hidhur te faljes neper rruge, ne mungese te xhamiave te medha te cilat nuk po ndertohen qe nga vitet 1940 neper hapesirat shqiptare, ku elementi musliman eshte shumice e padiskutueshme. Prandaj, u kujtuam me kete shkrim muslimaneve te Tirane, qe te demostrojnë kunder atyre qe nuk u japin leje per te ndertuar nje xhami, kur parret dhe truadhin e kane te tyren per te plotesuar kete kerkese e cila ka baze fetare dhe ligjore per t'u marre parasysh dhe per t'u plotesuar nga ata qe jane ne pushtet me votat e votuesve muslimane te cilet, ne te ardhmen, duhet te mendohen para se te votojne, qe votat e tyre t'i marrin ata qe do te zotohen te plotesojne kerkesat e ummetit musliman ne Tirane dhe ne te gjithë Shqiperine.

Selim Gokaj

Përdorimi politik i islamofobisë në Shqipërinë paskomuniste

Me rrëzimin e komunizmit në Shqipërinë e viteve 1990, në vendin tonë pati një rilindje fetare, ku ndër fetë më të rëndësishme që u rimëkëmbën ishte padyshim edhe Islami. Gjatë viteve të ndërtuara një numër xhamish dhe shkollash në mbarë vendin. Aktivitetet fetare të muslimanëve u organizuan nga Komuniteti Musliman, Kryegjyshata Botërore Bektashiane, si dhe nga një numër i vogël tarikatesh sufiste dhe OJQ-sh islame, të cilat me ndihmën e organizatave të huaja dhe vendase u përpoqën të rindërtojnë sa më shumë infrastrukturën fetare të vendit, që ishte shkatërruar më parë nga komunizmi.

Megjithatë me hapjen e Shqipërisë ndaj perëndimit, disa nga ish-aparatçikët komunistë, të cilët në të kaluarën kanë qenë në krye të shtypjes së fesë në vend, kësaj here protestuan dhunshëm kundër asaj, që ata e konsideruan si ri-islamizim të Shqipërisë. Ismail Kadareja, i cili është i mirënjohur për ndjenjat e tij kundra fesë gjatë regjimit komunist, ka vazhduar të udhëheqë fushatën kundër ri-islamizimit të Shqipërisë edhe pas rënies së sistemit.

Vetëm se pas rënies së komunizmit militantizmi i Kadaresë në mbrojtje të ateizmit është kthyer në një dëshirë të madhe të tij për të konvertuar shqiptarët në të krishterë katolikë. Idetë e Kadaresë mbi Islamin dhe Krishterimin në Shqipëri u bënë të qarta në vitin në 1991, kur ai deklaroi se:

Prija e Shqipërisë do të ishte drejt fesë së krishterë, ngaqë ajo lidhet me kulturën, kujtimet e vjetra, dhe nostalgjinë e kohës paraturke. Me kalimin e viteve, feja e vonë islamike, e ardhur bashkë me otomanët, do të zbehej (së pari në Shqipëri e më pas në Kosovë), derisa t'ia linte vendin fesë së krishterë, ose më saktë kulturës së krishterë. Kështu që së paku nga një e keqe (ndalimi i fesë më 1967) do të vinte një e mirë. Kombi shqiptar do të bënte një korigjim të madh historik, çka do të shpejtonte bashkimin e tij me kontinentin mëmë: Evropën.

Siç kuptohet më lart, Kadareja e konsideron futjen e shqiptarëve në Fenë Islame si një gjynah historik. Kadareja, që gjatë kohës së komunizmit dhe ditëve të sotme portretizohet nga disa si "babai i kombit" dhe "fytyra publike" e Shqipërisë në Perëndim, në ditët

tona mund të konsiderohet pa frikë edhe si arkitekti kryesor i islamofobisë dhe turkofobisë në Shqipërinë moderne. Nderimi që Enver Hoxha kishte për të dhe statusi i lartë politik, që ai gëzon sot falë lobit të fuqishëm francez, si dhe nderimit publik të Sali Berishës ndaj tij,11 e kanë kthyer Kadarenë në një shenjtor të gjallë të ideve të njeriut pas-komunist në Shqipëri. Megjithatë këndvështrimet raciste të tij kundër Islamit, Azisë, turqve, arabëve, romëve, vllahëve etj., kanë krijuar shumë kundërshtime publike në Shqipëri dhe Kosovë para të demokracisë në Shqipëri, muslimanët arritën të cilat shumë njerëz i kanë konsideruar raciste dhe islamofobike. Në pjesën më të mëdha të shkrimeve dhe novelave të tij, Kadareja e barazon Islamin me një të keqe të madhe. Nëse gjatë kohës së komunizmit për Kadarenë e mira simbolizoheshin me komunizmin dhe e keqja me kapitalizmin, në Shqipërinë paskomuniste Kadareja të mirën absolute e projekton drejt Perëndimit, ndërsa të keqen drejt Islamit, Azisë dhe turkut. Siç edhe Sulstarova tregon në librin e tij të sipërpërmendur, në punimet e Kadaresë armiku kombëtar i shqiptarëve gjatë periudhës së komunizmit, por edhe pas rënies së tij mbetet turku dhe feja e vet.

Islamofobia që Kadareja rrëfen në trajtimin e turkut është e lidhur në mënyrë të pashmangshme me fenë e tij: Islamin. Këtë e gjejmë tek novela "Ura me tri harqe", ku Kadareja ardhjen e Perandorisë Osmane në Shqipëri e rrëfen si "diçka të errët që shfaqet në horizont: Shteti Turk. Shteti Turk i imagjinatës kadarejane tregohet feudal dhe dashakeqës, aziatik dhe i errët, i cili ka Islamin si komponentin kryesor të tij. Ndër të tjera Kadare flet për "Hijet e minareve të tij po na arrijnë".

Kadareja i portretizon turqit si njerëzit që sjellin errësirën në Evropë.

Për Kadarenë qëllimi kryesor që turqit kishin në Evropë dhe Shqipëri (e cila portretizohet si mbrojtësja e kufijve të qytetërimit perëndimor) është shkatërrimi i shqiptarëve dhe azifikimi i tyre. Dhe nëse ata rezistonin, turqit planifikonin t'i zëvendësojnë shqiptarët me arabë, në mënyrë që civilizimi evropian të ngelej pa rojet e tij shqiptarë.

Racizmi dhe islamofobia e Kadaresë vazhdon të shfaqet edhe në shkrimet e tij të ditëve të sotme. Në esenë "Identiteti evropian i shqiptarëve" (botuar në 2006) islamofobia dhe racizmi i veprës së Kadaresë ndërlihet me të ashtuquajturën luftë kundër terrorizmit, ku Kadareja përpiket t'i bindë shqiptarët, që si evropianë që ata janë duhet të divorcohen nga Islami. Në esenë në fjalë Kadare sulmon pjesëmarrjen e Shqipërisë në Organizatën e Konferencës Islamike, si dhe përpjekjet e disa intelektualëve shqiptarë që i përshkruajnë shqiptarët si muslimanë. Ai i sulmon personat që e shohin Shqipërinë si pjesë të botës muslimane, madje sulmon edhe praktikën fetare të besimtarëve muslimanë, siç është përulja e tyre gjatë faljes.

Sipas Kadaresë shqiptarët janë vetëm evropianë16 dhe si të këtillë nënkuptohet të jenë anti-islamë. Duke e ndarë botën në dy pjesë – në perëndim dhe atë që mbetet prej tij - Kadare deklaroi se Shqipëria nuk mund të bëjë pjesë sa në Azi aq edhe në Evropë, por ajo bën pjesë vetëm në Evropë, dhe si rrjedhojë nënkuptohet, që i përket vetëm krishterimit.

Për Kadarenë, Islami që osmanllitë sollën në Shqipëri ishte një lloj i veçantë Islami. Sipas tij osmanllitë sollën në Shqipëri një Islam, që është inferior ndaj krishterimit katolik. Për Kadarenë inferioriteti i Islamit turk shihet edhe në fushën e artit otoman, i cili sipas tij prodhoi një "të ashtuquajtur letërsi erotike" që "në një pjesë të madhe të saj s'ishte gjë tjetër veçse bejte dhe lavde për pedofilinë". Ky lloj Islami paraqitet nga Kadareja si reaksionar dhe i prapambetur. Si pasojë e kësaj natyre që Islami turk ka mbjellë në Shqipëri, Kadareja arsyeton strehimin, që i bën traditës ky Islam, i cili bën që "Parazitë të shumtë do t'i ngjiteshin kësaj feje, sidomos në shekullin e njëzetë, duke përfshirë edhe të fundit, atë më të rrezikshmin, terrorizmin".

Ideja që Islami qëndron në pozita antagoniste me Evropën dhe modernitetin, dhe që kjo është një nga arsyt pse Shqipëria vuan nga gjendja e mjeruar ekonomike është përsëritur shpesh në këto 17 vitet e fundit nga shumë intelektualë ish-komunistë të vendit tonë. Përdorimi politik i islamofobisë lexohet qartë në politikën shqiptare të ditëve tona, ku Partia Socialiste e

Shqipërisë ka qënë gjithnjë në pararojë. Zyrtarët e PSSH-së që janë kryesisht ortodoksë nga jugu i Shqipërisë, gjatë fushatave të tyre politike kundër Berishës e kanë akuzuar vazhdimisht atë sikur kërkon të islamizojë jo vetëm Shqipërinë, por edhe vetë Evropën. Kur socialistët erdhën në pushtet më 1997, ata nisën një fushatë historike anti-muslimane të drejtuar në mënyrë të veçantë kundër vendeve muslimane,18 antarësimit të Shqipërisë në OKI, si dhe rikonstruktimit të xhamive dhe medreseve, që ishin mbyllur ose shkatërruar nga paraardhësit e socialistëve tre dekada më parë. Hierarkia e Partisë Socialiste në Shqipëri e ka trajtuar në mënyrë të vazhdueshme Islamin si një nga arsyt kryesorë pse Shqipëria nuk pranohet nga Evropa e Krishterë. Neshat Tozaj, një nga eksponentët kryesorë socialistë në vitin 1995 deklaronte se:

"Shqipëria po troket fort në dyert e Evropës kur në të vërtetë ka hyrë në Lidhjen Islamike... Mbi Shqipërinë po rëndon prej kohësh damka e një vendi musliman, damkë të cilën ia kemi stampuar vetë me hekur të skuqur në ballë... [Skënderbeu] ka luftuar kundër turqve osmanë për çerekshekulli dhe ka triumfuar jo vetëm për të ruajtur Shqipërinë, por edhe për t'u bërë barrierë e ruajtjes së krishterimit evropian".

Deklaratat e mësipërme të Tozajt kundër OKI-së dhe të qenit musliman, të cilat Tozaj i cilëson si një "damkë", lidhen me një shkrim që ishte botuar në Paris disa muaj më parë, ku Shqipëria ishte quajtur depo e fundamentalizmit islamik. Duke e imagjinuar Islamin si një forcë të keqe në botë apo si "një damkë të stampuar me hekur të nxehët në ballë", Tozaj propozon që në vend të mbahet një referendum kombëtar, që nëpërmjet tij t'i vërtetohet Perëndimit se muslimanët në Shqipëri janë një minoritet i vogël dhe i parëndësishëm.

Olsi Jazexhi

vijon në nr. tjetër

PROMOVOHET BOTIMI I FORUMIT MUSLIMAN SHQIPTAR

“INTEGRIMI I SHQIPTARVE NE EVROPE DHE VLERAT QE ISLAMI PERCJELL NE KETE INTEGRIM”

Me daten 11 tetor 2008, ne qytetin e Kavajes eshte bere promovimi i botimit te Forumit Musliman Shqiptar “Integrimi i muslimaneve shqiptare ne Evrope dhe vlerat qe percjell ne kete integrim”. Ky promovim u organizua ne sallen e nje ambjenti qe eshte prone e vellezerve Haveriku te cilet ishin edhe organizatoret e ketij aktiviteti. Botimi ishte nje sinteze e referencave qe jane bere ne simpoziumin kombetar “Integrimi i shqiptarve ne Evrope dhe vlerat qe islami percjell ne kete integrim” i cili u zhvillua ne Kavaje me daten 2 shkurt 2008.

Ne promovimin e ketij botimi moren pjese Kryetari i Fo-

rumit Musliman te Shqiperise Fisnik Kruja , nenkryetari i Forumit Musliman Shqiptar, Nexhmi Haveriku, drejtuesi i Kishes Autoqefale Ortodokse Shqiptare At Nikoll Marku, Kryetari i Bashkesise Islame te Malit te Zi Isuf Gjokaj, Analisti dhe diplomati i njohur shqiptar Abdi Baleta , studiuesi dhe gazetari i njohur Olsi Fazexhi , te ftuar nga Kosova dhe Maqedonia dhe miq te tjere te ftuar per te marre pjese ne kete promovim. Aktivitetin e hapi nenkryetari i Forumit Musliman Shqiptar Nexhmi Haveriku i cili falenderoi pjesmarresit dhe njekohesisht i uroi pune te mbare ketij aktiviteti. Ne emer te Forumit Musliman Shqiptar per-

shendeti z. Fisnik Kruja i cili vuri ne dukje rendesine e ketij aktiviteti dhe njekohesisht foli per vlerat e Forumit Musliman Shqiptar dhe qendrimin e tij ndaj situatave politiko -fetare ne Shqiperi. Pastaj fjalën e moren zoterinjtë Abdi baleta, Olsi Jazexhi, At Nikoll Marku,

Myftiu I Kavajes Besnik Lecini, imam Xhafer Shkodra, miku nga Kosova Fahri Rexhepi. Teologu shume i njohur nga Maqedonia, Zekeria Bajrami. dhe Myftiu i Malit te Zi Isuf Gjokaj. Diskutantët vleresuan botimin e materialeve te simpoziumit te mbajtur me 11 tetor 2008 dhe falenderuan vellezerit Haveriku qe e sponsorizuan

kete botim. Ne kumtesat e tyre zoterinjtë folen edhe per gjendjen aktuale te islamit ne Shqiperi dhe islamofobine qe po merr permasa te frikshme duke penalizuar dhe akuzuar muslimanet dhe ne pergjithesi boten islame. Pas perfundimit te aktivitetit per te pranishmit u shtrua nje dreke. Mendojme qe per kete aktivitet duhen falenderuar vellezerit Haveriku qe e sponsorizuan dhe nga ana tjeter ishin po vellezerit Haveriku qe vune ne dispozicion ambjente per organizimin e ketij aktiviteti. Allahu ua shperblefte me te mira ne kete jete dhe ne jeten tjeter.

Selim Gokaj

ZGJIDHET KRYETARI I RI I BASHKESISE ISLAME TE KOSOVES

Me date 18 tetor 2008, ne Prishtine, eshte bere mbledhja e Kuvendit te Bashkesise Islame te Kosoves i cili, ne nje mbledhje te zakonshme te tij, pati ne rendin e dites edhe zgjedhjen e kryetarit te ri te Bashkesise Islame te Kosoves i cili do te kete nje mandate 5 vjecar per te kryer detyren e tij ne interes te komunitetit musliman te Kosoves dhe gjithashtu ai eshte i obliguar qe te punoje edhe per interesat e te gjithë popullit te Kosoves. Kandidate te mundshem per kryetar te Bashkesise Islame te Kosoves ishin Mr. Naim Ternave , z. Rexhep Boja , z. Ekrem Simnica dhe te tjere. Pas nje votimi shume te rregullt dhe transparent, u rizgjodh Kryetar i Bashkesise Islame te Kosoves Mr. ef. Naim Ternava i cili mori 70% te votave te anetareve te kuvendit qe moren pjese ne votim. Me daten 25 tetor, ne xhamine “Sulltan Murati” te Prishtines u be ceremonia e dorezimit te mandatit nga Kuvendi i Bashkesise Islame te Kosoves. Ne kete ceremoni merrnin pjese kryetari i sapozgjedhur i Bashkeise

Islame te Kosoves, Mr. Naim Ternava i cili beri edhe betimin e rastit. Gjithashtu ishin ne kete ceremoni myftilere , anetare te kuvendit , drejtues te ndryshem te fese islame, Kryetari i Bashkesise Islame te Maqedonise Sulejman ef. Rexhepi, Kryetari i Bashkesise Islame te Malit te Zi , Myftiu I Bosnjes, perfaqesues te institucioneve humanitare te ShBA, si thirrresi ne islam Burhan Al Din Fili, deputete dhe perfaqesues nga qeveria e Kosoves. Ishte e habitshme mospjesemarrja e perfaqesuesve nga KMSH shqiptar te cilet, nga informacioni qe ne morem, ishin te ftuar edhe ata ne ceremonine e zgjedhjes se Kryetarit te ri te Bashkesise Islame te Kosoves.

Ceremonia eshte mbyllur me nje dreke ne Grand Hotel “Prishtina”

Haxhi Vehbi Dani

Kryetar i Shoqates Bamirese Islame Shkoder

DJE TË PERSEKUTUEM, SOT TË HARRUEM

Me mija njerëz u zhdukën...
eshtrat iu tretën...
Dhimbsuni as dorë kërkuese
ende nuk gjetën.
Në komunizëm të përndjekun
e sot të harruem,
Shpresa u cfilitet...
si valët rrahin në shkumë.
Kudo që të udhëtosh
në trollin e Shqipnisë,
Dëgjon thirrjet e shpirtave
kërkuese t'pafajësisë.
Me djersën dhe gjakun e tyne u ushqye
burrnia,
Me të cilën asht shque
dhe krenohet Shqipnia.
O bijtë e dhimbjes e të pikëllimit,
mos u dorëzoni kurrë,
Vazhdoni përpjekjet tueja,
qëndroni si curr!
Të shumta janë hallët e vujejtet...
sa s'kanë mbarim,
Shpresat e breznive
kthe në mirazh e mashtrim.
Të zotët e vërtetë t'pronave
hallin s' dinë kujt t'ia qajnë,
Horat e djeshëm i gllabruen,
të sotmit peng i mbajnë.
Por ju, o vllazën e motra,
kurrë mos u gjunjëzoni,
Në se ju sot s'i merrni...
fëmijëve tuej kallxon...
Në tunelin e errësinës
drita kund nuk duket,
Qëndroni të vendosun
shpresa mos t'ju zhdukët!
Keni rrugë të gjatë
që duket se s'ka mbarim,

Ecni përpara...
se mbrapa s'ka kthim.
Qeveritë hibride
nga mitra komuniste vijnë,
Shpresës s'dëshpruemve
me shpinë ftohtë iu rrinë.
Të persekutuemit politikë
enden n'rrugë t'harresës,
Qeveritë që shkojnë e vijnë...
“sikter” i thonë besës.
Se në të vërtetë ata janë
vazhdim i s'djeshmes,
Lindje të vdekun,
ata i sjellin t'nesërmes.
Për vujejtet e hallët tuja
kallëzoni fëmijëve tuej,
Mos ia lejon vetes
t'iu bahet gjaku ujë!
Ta dini mirë se të parët tuej e Zoti vetë:
Kurrë s'kanë me ua falë,
hallall s'ua bajnë për jetë!
Porositni fëmijët tuej
që vëzhgues mos t'rrinë,
Me sjellje si u ka hije
serish mund të prijnë.
Ashtu si kanë pri
ndër shekuj t'parët tuej,
Kalitni si duhet...
si hekurit i jepet ujë.
Zotit i lutem t'i ruej dhe t'i udhëzojë,
Që Atdeu i dashur gjithmonë të lulëzojë.
Amanetin që keni
fëmijët mirë duhet ta dinë,
Që mynxyrat komuniste
kurrë ma mos t'vijnë.

Burhan FILI USA

NDERROI JETE BASHKIM GAZIDEDDE

Pas nje semindje te rende, nderoi jete ish- kryetari i pare i Shoqates se Intelktualeve Muslimane shqiptare dhe drejtori I Sherbimit Informativ Kombetar ne qeverine e pare demokratike , Bashkim Gazidede. Ai vuante nga nje semundje e pasherueshme dhe megjithese u kurua ne Itali I sponsorizuar nga qeveria shqiptare, nderoi jete ne apartamentin ku banonte. Bashkim Gazidede do te mbahet mend si nje nepunes i larte i qeverise demokratike i cili drejtoi me kompetence sherbimin informative kombetar nga viti 1992 deri ne trazirat e vitit 1997. Pas ardhjes ne pushtet te socialisteve , ai u largua drej Turqise ku jetoi deri kur ne pushtet erdhi partia demokratike. Pasi u kthye nga Turqia ai perseri sherbeu prane

kesaj qeverie me detyren e drejtorit te hipotekave shqiptare, pune qe e beri me devotshmeri dhe ndershmeri . Bashkim Gazidede ka qene nje besimtar musliman I devotshem dhe praktikan I fese islame, por edhe nje meshirim I tolerances fetare ne mes te komuniteteve fetare ne Shqiperi. Intelktualet muslimane shqiptare e paten zgjedhur, kur u formua shoqata e tyre kryetar te saj, gje qe u perdor nga individe dhe qarqe te caktuara per ta akuzuar si nxites I nje islamizmi radikal. Para se te angazhohej ne politike, Gazidede ka qene pedagog matamatike ne Universitetin e Tiranës te cilit i la trashegim botimin e 5 librave te cilet jane pjese e informacionit dhe e dijes per studentet e deges se matematike-fizikes ne

universitetin e Tiranës dhe me gjere. Opozita politike e majte ka ushqyer nje urrejtje patologjike ndaj Bashkim Gazidedes duke shfrytezuar mundesite e pakufizuara mediatike qe ka ne dispozicion per te njollose figuren e tij politike dhe qytetare, por pa sukses, sepse ai ishte dhe mbetet modeli i nje nepunesi te larte qeveritar qe karakterizohej nga ndershmeria, devotshmeria dhe sakrifica ne kryerjen e detyres se ngarkuar nga qeveria dhe shteti shqiptar . Ai jetoi ne nje apartament te zakonshem dhe nuk pati bisneze , as vila dhe autovetura kuksoze. Bashkim-Gazidede e dinte mire se kush ishin armiq e popullit shqiptar prandaj i demaskoi ne parlamentin shqiptar, demaskim qe arriti kulmin kur ai, ne nje inter-

pelance beri portretin e qarqeve shoviniste greke qe ishin violine e pare ne rebelimin e rrezikshem te vitit 1997. Shqipetaret dhe nepunesit e shtetit shqiptare , te majte dhe te djathe kane nevojte jetike te mesojne nga pervoja qe la pas ky nepunes i larte i qeverise shqiptare i cili tregoi se antikurropsioni, nacionalizmi, ndershmeria, disiplina ne pune dhe qendrimi i prere dhe pa kompromis ndaj armiqve te Shqiperise, qe jane prane kufijve tane dhe me larg, duhet te jene parametrat mbi te cilet duhet ta ndertojne ata punen e tyre dhe pikerisht keto parametra duhet te jene modeli i perdorur nga keto nepunes per te kryer detyrat qe u cakton qeveria shqiptare dhe shteti shqiptar.

Selim Gokaj

SALI BERISHA APO SALI RAME BERISHA

Eshte bere dukuri e politikes shqiptare qe sharjet edhe fyerjet e qeveritarve dhe e opozitarve ne adrese te njeri tjetrit te marrin permasa te tilla, sa ata nuk kursejne as emrat e prinderve te tyre per te rritur kurben e fyerjes se politikanit qe kane vene ne shqinjester. I lakuar me shume se te tjeret ne kete parameter ka qene kryeministri shqiptar, Sali Berisha, te cilit emrin e babait te tij ia di i gjithe populli shqiptar , fale politikaneve te majte qe, pasi i kane konsumuar te gjithe epitetet me te renda kunder tij, i kane kujtuar edhe emrin e babait duke e quajtur Sali Rame Berisha. Se fundi kete (pa) nder pati fatin ta percjelle ne media nje politikan i majte qe opinjoni publik nuk e njeh si ortak ne sharje me socialistet e tjere te cilet duket se bejne kurse kualifikimi qe te kapin parametrat me te larte per sharje dhe per fyerja ndaj kundershhtarve politike te tyre. Ne nje debat televiziv , ne emisionin Opinjon te Blendi Fevziut , Pandeli Majko deklaroi se Damir Fazllicin e kishte sjelle ne Shqiperi Sali Rame Berisha.



Pohimi i tij do te kishte vlere te njejte edhe sikur te shprehej se biznesmenin boshnjak e kishte sjelle ne Shqiperi Sali Berisha, pa cituar aspak emrin e babait te tij i cili edhe nuk jeton me. Por me gjithe ate, Pandi Majko nuk e ka arritur shenjestren e tij per te perdorur emrin e Rame Berishes per te fyer kryeministrin shqiptar, sepse Rame Berisha ka qene

nje emer i nderuar ne te gjithe Tropojen dhe ne te gjithe Gjakoven. Ai ka qene nje njeri shume i njohur qe ka jetuar ne nje kulle 4 kateshe dhe ne shtepine e tij ka pase arka te drunjta te mbushura me libra te cilat i ka kaluar vete neper duar per t'ua lene me pas femijve te vet. Pikerisht Rame Berisha, i jati i Sali Berishes, eshte i njohur si nje besimtar i de-

votshem musliman dhe si nje praktikan i fese islame te cilin as sistemi komunist nuk arriti qe ta pengojte per te fale pese vaktet. Vete Pandi Majko e di shume mire se kulla 4 kateshe e ketij Rame Berishes ishte nje baze e fuqishme e luftetareve kosovare qe luftuan kunder serbeve ne lufte e fundit qe u be ne Kosove dhe pa tjetër edhe para saj. Emri Rame nuk shpreh as injorance , as prapambetje. Ai eshte nje emer musliman qe e larteson nje njeri qe e ka kete emer. Prandaj, Pandi Majko gabon kur mendon se mund ta penalizojte kryeministrin shqiptar, duke i kujtuar se eshte djali I Rame Berishes. Duke e njohur portretin e sakte te ketij tropojani trim, te zgjuar , patriot , fetar dhe arsimdashës, ne mendojme qe, jo vetem Sali Berisha eshte krenar qe ka pase baba Rame Berishen, por nje privilegj te tille do ta kishte quajtur vlere secili njeri te cilit do t'i kishin kujtuar se eshte i biri i nje babait me vlerat e Rame Berishes.

Selim Gokaj

PERSEKUTORET E INVESTIMEVE ARABE NE SHQIPERI

Klima e re ekonomike dhe politike qe u vendos ne Shqiperi pas rrezimit te diktatures komuniste krijoi hapesira per investoret e huaj per te investuar ne ekonomine shqiptare pa bere dallime partiake dhe shteterore, sepse tashme pushtetarët shqiptarë krenoheshin se ishin mikprites per te gjithë investitorët e huaj, duke u betuar se persekucionet ndaj te huajve, qe do te vinin ne Shqiperi, i perkisnin te kaluaret diktatoriale..Kjo ishte edhe arsyeja qe, krahas investitorve nga hapesirat evropjane, ne dyert e biznesit shqiptarë trokiten edhe investitorët arabe, te bindur se Shqiperia ishte nje vend ku mund te fitohej ne biznes dhe nga ana tjeter mund te ndihmohej nga biznesi , sepse pasojat qe la pas komunizmi ne kete vend te vogel ishin katastrofike dhe te krijonin idene se veshtire qe ekonomia shqiptare do te rimekembet dhe do te rikuperohej per te pase parametrat qe kerkon ekonomia e tregut ku ajo sapo po bente hapat e para.Por, nese ardhja e investitorve arabe ishte e mirepritur ne vitet e para te ndryshimeve pluraliste ne Shqiperi , vitet qe do te pasonin do te ishin deshmitare te persekutimit te investitorve ara-

be dhe te ngritjes se akuzave kunder tyre, duke synuar largimin e tyre nga hapesirat shqiptare. Laku ndaj investitorve arabe filloi te shterngohej sidomos pas 11 shtatorit, kur filluan te aplikohen masa drastike ndaj investimeve arabe ne Perendim ,duke i akuzuar biznesmenet arabe ne keto hapesira per terrorizem dhe per pasoje investimet dhe llogarite rrjellose te tyre konfiskoheshin dhe bllokoheshin duke pasuar falimentimin e tyre ne rastin me te mire dhe ne rastin me te keq arrestimin e tyre ne qeli, ku investitorët arabe do te rrinin edhe me vite pa dale ne gjyq, deri sa te zbardhej dyshimi ndaj tyre ,afat kohor ky i paracaktuar , parameter ligjor i papare ndonjehere ne vendet qe pretendojne se jane demokratike. Shqiperia, si vend i angazhuar politikisht dhe ekonomikisht ne linjen e boshtit antiterror ,filloi "gjuetine e shtrigave", per te plotesuar parametrat e detyrimeve qe duket se ka marre per te qene "me katolike se papa" ne ate qe ishte etiketuar si lufte kunder terrorizmit(lexo lufte kunder muslimaneve).Dhe sulmi filloi se pari kunder dy kullave binjake ne Tirane te cilat ishin investim i nje

biznesmeni arab qe u etiketua si terrorist gje qe solli konfiskimin e pasurise se tij edhe ne Tirane. Ne media u dhane gjyqje te panderrprera per te vertetuar se ky biznes ishte i dyshimte dhe financues i terrorizmit ne nje kohe qe sot rezulton se te gjitha akuzat jane te pabaza dhe pronat e ketij biznesmeni do te kthehen perseri tek i zoti, sepse prokuroria nuk arrin te siguroje deshmitare per te provuar akuzat kunder ketij biznesi. Ne media u dhane edhe deklarata te tilla nga Maks Velo se keto kulla duhen rrezuar sepse, sipas tij prishin bukurine e Tiranes ,ne nje kohe qe ata jane sot krenaria e bukurise se Tiranes Pronat e konfiskuara te biznesit arab mund te kthehen dhe mund t'i marre perseri zoti.Por, biznese te tjera arabe do te ngurrojne te instalohen ne Shqiperi, sepse nofka e terrorizmit u rri mbi koke si rrezik qe mund t'i dergoje ne qeli ose me se paku t'u konfiskoje bizneset e tyre. Prandaj, duhen marre masa qe te ndeshkohen ata qe kane bere dhe bejne reperkursione ndaj biznesmeneve arabe dhe etiketimet qe u behen atyre per terrorizem.Kurse masat perjashtuese dhe ligjore ku-

nder tyre duhet te ekzekutohen vetem kur ato te vertetohen me vendime gjykate dhe jo me vendime kaq perjashtuese "qe merren me vesh", sepse mund te kerkohet edhe ndihme nga vendet arabe, kur ne kemi nevojte dhe te vrapojne drejt tyre diplomatet me te larte te shtetit , si ne e rastin e njohjes se Pavaresise se Kosoves nga ana e tyre. Dhe te mos harrojme se miqte ta percjellin miqesine vetem, kur ata trajtohen si miq dhe jo si te padeshruar.Deshtimi i gjykates per te marre mase denimi ndaj administratorit te biznesmenit Jassin Kadi tregoi se goditja ndaj biznesmeneve arabe eshte e padrejte dhe e demshme per interesat politike dhe ekonomike te Shqiperise dhe se inskenimet me terroriste arabe qe veprojne ne Shqiperi duhet te marrin fund qe arabet, te cilet jane dashamires te shkelqyer te Shqiperise dhe te shqiptareve, ta ndjehne vehten te barabarte ne mes te barabarteve per te qene edhe ata pjese e biznesit te huaj ne Shqiperi

Pergaditur nga redaksia e gazetes Besimtari

LUFTA KUNDER TALEBANEVE NUK MUND TE FITOHET

Në një komunikatë të lëshuar nga Pentagoni, thuhet se situata në Afganistan po tensionohet pa ndërprerje duke na bërë të mendojmë se luftën në Afganistan amerikanët nuk mund ta fitojnë , as së bashku me mbështetjen që po japin trupat e koalicionit qe jane shtete të angazhuara direk në këtë luftë te cilet po e rrisin pa pushin numurin e trupave të tyre në këtë front të rrezikshëm lufte. Shqetësimi i Pentagonit bazohet pa tjetër tek rezistenca e ashper që po u bëjnë luftëtarët talebanë trupave të koalicionit që po pësojnë humbje të rënda nëpër fushëbeteja aq sa, sot nje pjesë e madhe e territorit të Afganistanit kontrollohet nga trupat e luftëtarëve talebanë, të cilët duket se po shfrytëzojnë eksperiencën e tyre nga lufta që bënë para shumë viteve me trupat sovjetike të cilat i detyruan të kapitullojnë dhe të largohen të mu-

ndur nga Afganistani. Në përpjekje për të qetësuar situatën, mbreti kukull i Afganistanit, Karzai, i ka kërkuar shtetit të Arabisë Saudite që të ndërmjetësojë tek luftëtarët talebanë për të realizuar një raund bisedimesh në mes të qeverisë së Kabulit dhe të talebanëve që faktikisht nuk e njohin këtë qeveri, që sipas tyre, mbështetet nga trupa pushtuese dhe lufton së bashku me ata në përpjekje për të eliminuar repartet e luftëtarëve talebanë.Kjo situatë e tensionuar përfaqëson pasojat të rrezikshme për rajonin dhe për vetë popullin afgan, ku vrasja e civilëve nga bombardimet është bërë një gjë e zakonshme dhe po kaq e zakonshme është bërë edhe kërkesa për falje nga ata që hedhin bomba, por që këta kërkesa nuk mund të ngjallin viktimat civile që më së shumti janë gra ,fëmijë dhe të moshuar.Duket se ata që i larguan nga pushteti talebanët nuk

patën parasysh se afganet jane nje popull luftarak qe nuk mund te jetoje gjate ne pranine e nje pushtiesi sado o fshehur pas sloganeve ;"Se bejme lufte kunder terrorizmit me trupa paqeruajtëse" ku arma historikisht nuk ka sjelle kurrrë paqen. Situata ka arritur ne nje pike ku, tashme per trupat e koalicionit antiterror nuk ka rrugëdalje, sepse alternativa ushtarake per t'u shkaktuar disfate talebaneve ka deshtuar. Vete komandanti i trupave angleze, Mark Smith, pohoi se lufta kunder luftetarve talebane nuk mund te fitohet dhe se nje zgjidhje ushtarake tashme ka deshtuar. Mendojme se luftetaret talebane jane ne poziten e fituesit per shume arsye, ku pa tjetër është edhe armatosja e tyre me arme moderne dhe pa dyshim viktimat e shumta ne mesin e civileve nga bombardimet ajrore dhe tokesore te koalicionit kane ndikuar per nje

qëndrim te ashper te popullsisë qe duket se i furnizon me luftetare trupat talebane.Ne nje interviste te dhene ne Kabul, perfaqesuesi i OKB Kai Eide deklaroi;"Te gjithë ne e dime se kjo lufte nuk mund te fitohet me rruge ushtarake por duhet te fitohet me mjete politike, duke folur me ata qe jane te rendesishem dhe qe vlejne per te bere bisedime me ata.Keto qëndrimi po afishohen ne media, sepse numuri i trupave te huaja, qe jane vrare kete vit, është me i madh se cdo vit tjetër qe se është bere pushtimi i Afganistanit ne vitin 2001. Por, komanda e luftetareve talebane e ka refuzuar idene per bisedime, duke kerkur qe te largohen 70 mije trupat e huaja pushtuese, si kusht paraprak per bisedime ne mes te paleve.

Sipas informacioneve te mediave vizive

KRIZA FINANCIARE GLOBALE DHE SISTEMI FINANCIAR ISLAM

Në një kohë që një krizë e rrezikshme dhe pa rrugëdalje po shkakton ekonominë amerikane dhe tashti sapo ka sulmuar atë perëndimore, shumë gazeta perëndimore kanë bërë thirrje që të zbatohet legjislacioni islam në fushën e ekonomisë, për të shpëtuar nga kriza që po sjell katastrofën ekonomike e cila po mbulon sot gjithë botën. Revista e njohur "Challenge" ka shkruar një artikull me titullin "Papa apo Kurani", ku autori pyet për rolin e fesë kristiane që neglizhon përdorimin e kamatës që po e çon njerëzimin drejt katastrofës. Gazeta pyet rreth qëndrimit të kishës, duke i kërkuar falje Papës për këtë pyetje. Gazeta citohet duke thënë se, në se ata që kujdesen për bankat tona do të kishin respektuar dispozitat e Kuranit, nuk do të provonim këto katastrofa, sepse paratë nuk lindin para. Në një linjë është edhe gazeta "Le Zhurnal des Francë" që shprehet për domosdoshmërinë e përdorimit të legjislacionit islam të ekonomisë dhe të financës, për të shpëtuar tregjet financiare nga shkatërrimi total të cilat kanë bërë marrëdhënie të errta dhe jo ligjore financiare. Gazeta e quan të vetmen zgjidhje legjislacionin islam, pavarësisht se nuk

është në linjë me traditën perëndimore. Keshilli i lartë i Francës për Ekonominë mori vendim që të ndalojë të gjitha marrëdhëniet e errta dhe shitjet simbolike që janë veçori e sistemit kapitalist dhe tregjet financiare të veprojnë me sistemin islam të buonave të cilat janë të lidhura me kapitale të sigurta që u përshtaten ligjeve të legjislacionit islam. Ka shumë vite që analistë të njohur për situata ekonomik kanë tërhequr vëmendjen për rrezikun drejt të cilit po e çon ekonominë dhe tregjet financiare sistemi liberal kapitalist i cili mund të dalë nga kriza vetën duke u mbështetur në alternativën islame për rregullimin e ekonomisë dhe të financave. I formuar në vitin 1970, sistemi bankar islam ka si pikësynim të tij zhvillimin e sistemit bankar dhe burimet financiare në një linjë me legjislacionin islam. Kur flitet për islamin në financë dhe marrëdhënieve financiare, fjala është për respektimin e 5 parimeve bazë islame: ndalimi i kamatës, ndalimi mishitblerjes i bazuar mbi mashtrimin kumarin, ndalimin e marrëdhënieve financiare që lidhen me produkte që i ndalon religjioni islam që janë pijet alkoolike, prostitucioni, përballimi humbjeve nga

banka dhe klienti dhe tregues të tjerë financiarë që sigurojnë aktivitetin bankar në një rrugë ku rreziku i falimentimit është i përjashtuar. Avantazhet e aktivitetit bankar islam mbi atë perëndimor janë shumë aktuale, sepse aktiviteti bankar islam ka një rritje 15% në vit dhe aktiviteti i bankave islame dhe institucionet e sigurimeve islame deri në vitin 2007 arritën 500 miliard dollarë dhe vlera e kapitaleve të qarkullueshme, që respektojnë normat islame arritën 700 miliard dollarë. Sot, sistemi financiar islam praktikohet në gadishullin Arabik dhe në disa vende të Azisë lindore. Por, ai ka filluar të pranohet edhe në kontinentin amerikan dhe atë evropian. Anglia ishte e para që vendosi norma ligjore dhe taksat që simulojnë sistemin financiar islam, duke hapur njëkohësisht edhe bankën e parë islamike në Angli. Sot, rrjeti i bankave islamike është i tillë, ku vetëm në gadishullin Arabik ka 43 banka, 15 në Malajzi dhe 200 banka islamike të tjera janë në të gjithë botën. Në një libër me drejtim ekonomik të quajtur "Ekonomi e pamoralshme" autorja italiane, Loreta Napoleoni, bën thirrje për domosdoshmërinë e ligjit islam për financimin, për

të shpëtuar e ekonominë perëndimore e cila është përfshirë në një korrupsion të thellë në marrëdhënjet që mbizotërojnë tregjet. Autorja e librit pohon se ekuilibri në tregjet financiare realizohet vetëm me meritën e financimit islam, sepse dështoi portreti i ekonomisë islame si i barabartë me terrorizmin. Loreta Napoleoni pohon se financimi islam ka dinamiken më të lartë në financat e të gjithë botës dhe bankat islame janë alternativa më e mirë për bankat perëndimore. Ka më se 20 vjet kur, Maurice Allais, fitues i çmimit Nobel në ekonomi, ka pohuar krizën e ekonomisë globale kapitaliste duke kërkuar që sistemi bankar duhet të çojë interesin e bankës drejt zeros dhe përqindja e taksës të jetë jo më shumë se 2%. Këto veprime e eliminojnë kamatën dhe realizojnë edhe zekatin i cili është për ndarjen e një pjese të pasurisë të varfërve nga një individ ose nga një biznes, tregues keto të legjislacionit ekonomik financiar islam.

Materjali është marrë nga gazeta Shekulli datë 16 tetor 2008 me autor Genc Plumbi

GOZHDA E NASTRADINIT E GREQISE NE TOKEN E SHQIPERISE

Perseri në mediat shqiptare është evidentuar kërkesa absurde dhe e rrezikshme e Greqisë që të ndërtoje varrezat e ushtarve greke në Shqipëri të cilat janë vrare në territorin e Shqipërisë gjatë LDB në betejat me trupat fashiste italiane që i paten shpallur luftë Greqisë. Sipas mediave, një grup parlamentaresh greke i ka kërkuar qeverisë greke që të beje presion mbi shtetin shqiptar që ai të jete dakort për ndërtimin e ketyre varrezave, sepse po kundërshtoi shteti shqiptar ndërtimin e ketyre varrezave, atehere Greqia duhet të votoje kunder anetaresimit të Shqipërisë në NATO dhe në BE. Sipas pales greke, janë eshtrat e 8000 ushtarëve greke që kanë rënë në token shqiptare. Historiku i kësaj kerkese nuk është e dite-

ve të sotme, sepse ai ka filluar që në vitet, kur në pushtet ishte e majta socialiste dhe vazhdoi edhe me ardhjen në pushtet të demokrateve, por që ka një pauzë në këto momente, pauzë të cilën e cenoj me deklaratën e tij grupi i deputeteve të parlamentit grek. Duket se qeveria shqiptare sot duhet të ketë ndonjë arsye që i ka bërë këtë ngecje kerkeses greke, sepse po e kupton se "gozhda e Nastradinit" kësaj rralle do të ngulet fort dhe rrezikshëm në token shqiptare. Prandaj, edhe përplasja po fillon të marrë pamje dhe njerëz mund të ashpersohet dhunshëm, sepse këtu nuk është problemi tek ndërtimi i disa varrezave, por po behen përpjekje të motivohet pa të drejtë se ushtria greke ka luftuar dhe ka derdhur gjak,

jo për solidaritet me popullin shqiptar, por ato hapësira, ku ata luftuan, pretendohet nga qarqet e fuqishme politike dhe fetare greke se janë territore voroepiriotë (alias greke). Dhe greket dinake (pinjollët e Odise se Itakes) i bëjnë presion shtetit shqiptar me bllokimin e mundësive se tij për t'u anetaresuar në NATO dhe në BE. Për ata që e percjellin me kujdes politiken greke ndaj Shqipërisë, nuk ka asgjë të re në këtë qëndrim, sepse gjithmone presionet dhe shantazhet vazhdojnë të jenë baza nga ku ndërtohet politika helene ndaj Shqipërisë. E gjithë bota i merr eshtrat e ushtarve të rënë në token të huaj, që të prehen në token e vet si dukuri njerezore që eshtrat të prehen në token ku kanë lere. Kurse greket duan

të krijojnë "xhepa" dhe "gozhde Nastradini" të rrezikshme në territorin shqiptar. Le të shohim se cili do të jete qëndrimi zyrtar dhe përfundimtar i qeverisë shqiptare për kerkesën greke. Të shohim a do të jete në një linjë me qëndrimin ndaj Bollanos që e ka kthyer Himaren në një mikroMitrovicë në territorin shqiptar, apo kjo qeveri do të distancohet nga qëndrimet e meparshme filo-greke në trajtimin e shumë problemeve ku politika greke po i zgjat duart" si në mall të babes".

Vezhguesi

CILA ESHTË E KEQJA QE KA SJELLE ISLAMI NE SHQIPERI?

Ka vite, qe ne kete 12 vjecar, nje lukuni servilesh dhe hipokritesh , media te paguara dhe te orjentuar, po shfryejne mbi fatin tone te keq, sipas tyre, te te qenurit muslimane te shumices se shqiptareve. E mbetur ne mes te anarkise, egoizmit, servilizmit te atyre qe na drejtojne , shoqeria shqiptare po humbet identitetin e saj duke rreshqitur drejt vesit , amorales dhe pjeses me te erret te Perendimit i cili ka rolin e tij te jashtezakonshem ne parametrat e larte demokratike qe ka sjelle ne jeten njerezore dhe ne Shqiperi si edhe ne ndihmen qe ai ka dhene e po jep per problemin e Kosoves.. Ne keto momente, ne skenen politike dhe ate publike, dalin disa horra dhe servile karrieriste qe therrasin se e keqja e shqiptarve eshte se ata jane muslimane dhe kjo eshte arsyeja qe sot Perendimi nuk na do. Paskesaj, ngrihet nje stuhi ne shtyp me terroriste islamike, bomba ne hotele dhe shkolla, vrasje nga ekstremistete islamike dhe opinjone te tjera te keqja per islamin.. Nga gjithë kjo zhurme nuk po kuptohet se cila eshte e keqja qe i ka sjelle islami Shqiperise. Ajo qe te habit eshte fakti se perse nuk reagon kjo pjese e madhe e popullsisë qe eshte mbi 70%, por sillen sikur te ishte minorance e paperfillshme dhe jo si pjese dermue e popullsisë, gati –gati sikur muslimanet jane te zene ne faj qe kane origjine muslimane, ose sikur kane bere nje turp qe jane te tille per hir te nje servilizmi perendimor deri ne perulje. Por cilat jane te keqiat qe i ka sjelle islamizmi Shqiperise?

E verteta eshte se islamizmi, pasi u perqafua nga shqiptaret, u dha atyre lavdi dhe nderim ,kur ata filluan te sundojne ne Perendorine Osmane si ;vizire dhe pashallare,guvernatore, ministra dhe gjenerale, deri tek Mehmet Pasha i Egjiptit. Shqiptaret nuk ishin te sunduarit nga Perendoria Osmane , por ishin ata qe sundonin Perendorine Osmane.Kjo lavdi dhe ky respekt nuk u kishte ndodhur shqiptarve me perendorine romake dhe ate bizantine, ose me sllavet.Perqafimi i Islamit u dha shqiptarve bashkimin e dhe administrimin ne vilajete te te gjithe racës shqiptare sipas zakoneve dhe traditave te tyre, duke i mesuar shqiptaret te qeverisin , te drejtojne , te arsimohen ne shkolla te huaja nga ku dolën shkrimtare dhe



filizofe, politikane dhe teologe.Pikerisht nga ky grup i nderuar intelektualësh dolën edhe udhëheqësit e pare te Shqiperise se pavarur. Askush nuk mund te anashkaloje kontributin e Samiut,Abdyilit, Vaso Pashes,Hasan Prishtines,, Ismail Qemalit dhe Ahmet Zogut. Nuk duhet harruar se perqafimi i islamit u mbrojti shqiptarve identitetin e tyre kombetar te cilin e ve ne dukje edhe Edit Durhan, kur thote se ata fshatra qe ne Maqedoni , Mal te Zi dhe ne Cameri nuk u kthyen ne muslimane, sot nuk egzistojne me si shqiptare.Duhet te kujtojmë se pa Kosove , Tetove ,Laberi ,Frasher Erseke, Shkoder e Tropoje mund te mos kishim pasur Shqiperi nga synimet shoviniste te fqinjëve tane.Perqafimi i Islamit u dha shqiptarve sigurine e mostjetersimit dhe te mbrojtjes se problemit te tyre kombetar dhe asnjehere shqiptaret nen sundimin e nje shteti islamik nuk u shtypen, nuk u shfarosen dhe nuk iu ndryshuan emrat me force qyteteve te tyre dhe fshatrave te tyre.Ne menyre te vecante duhet te permendim mbeshtetjen qe ka dhene Turqia ne momentet e veshtira qe ka kaluar Shqiperia.Mbeshtetja dhe hija e rende ushtarake qe ka Turqia ne rajonin e Ballkanit e me gjere, bejne qe te dridhen shtete qe ia kane me hile Shqiperise.Mbeshtetje te tille te fuqishme nuk ka pase kurre

Shqiperia. Ne cilin vend te botes shqiptaret lejohen te shkojne lirshem dhe te priten si vellezer si eshte Turqia ku si vellezer priten muslimane dhe te krishtere? Ne cilat vende biznesmenet shqiptare shkojne lirshem dhe priten pa paragjykime dhe me korrektesi si ne e vendet islamike? Me thoni nje vend fqinj, apo me gjere qe i prët shqiptaret si i presin ne vendet islamike? Cilat ishin shoqatat humanitare te cilat erdhen ne Shqiperi dhe qe shperndane ndihma dhe hapen kurse per biznes dhe menaxhim dhe me vone u perzune te tera te dyshuara per terrorizem, pa u vertetuar asgje me vendime gjykate, por u larguan thjeshte se ishin arabe? A nuk ishin vendet islamike qe sollën ndihmat me te medha per luftën e Kosoves? A nuk ishte Turqia islamike, e cila ne vitin 1991, kur Shqiperia nuk kishte buke, dergoi vaporet me miell per popullin vella shqiptar? Sot, shtetet perendimore bejne te pamunderen qe te mbajne lidhje te gjithanshme me vendet arabe. Kurse ne, qe jemi veteshpallur perendimore, i largojme arabet per hir te servilizmit te shtire se po luftojme terrorizmin duke u armiqësuar keshtu me arabet.Prandaj, ne pyesim sot se cila eshte e keqja qe na ka sjelle islami arab, turk apo shqiptar ne shqiptarve ne keto vite demokracie? A ka pase raste te te-

rrorizmit islamik nga individe dhe grupe muslimanesh ne Shqiperi? Me thoni nje rast te nje drejtuesi shtetror, qe eshte besimtar musliman, qe te jete akuzuar per korruption , trafikant, imoral , ose qe ka bere vjedhje , vrasje perdhunin , apo terror?

Me thoni nje rast nga djemte qe shkojne ne xhami , i cili merret me droge, eshte pijanec ,ose nuk respekton prinderit e tij dhe te moshuarit? Perse nga familjet muslimane, qe jane besimtare, nuk ka asnje prostitute? Pra , kur besimtarët muslimane rrezatojne vetem miresi, per te cilen ka kaq shume nevojë shoqeria e semure shqiptare , perse sulmohen muslimanet dhe perse i fryhet ketij zjarri , perse nxitet ndezja e tij, kur ai nuk egziston dhe perse kembengulet qe ai te egzistojë? Kush eshte i interesuar qe ky vend te quhet vend islamik, ne nje kohe qe nuk mungojne edhe nofka te tilla per Shqiperine si:shtet kriminel, trafikant, immoral? Zoti na ruajt nga keto zullumqare qe po shtohen kaq shume ne kete vend.

Dr. Bujar Rama

Materjali eshte marre nga gazeta "Albania" 2003

"Besimtari" e boton per pëmbajtjen aktuale te materjalit

SHTETET PERENDIMORE UA DOREZUAN SERBEVE SREBERNICEN

Krimi kunder civileve eshte nje fakt qe nuk kalohet lehte nga kujtesa njerezore, sidomos kur numuri i civileve te pafajshem kap shifren e mijrave te cilet i largojne ne menyre te dhunshme nga jeta pa qene te angazhuar ne asnje aksion luftarak, ose ne veprime te ngjashem me kete. Sidomos, masakra e Srebernice vazhdon te trondise shpirtirat e atyre qe humben njerezit e tyre te dashur ne kete masaker dhe po kaq tronditese mbetet Srebernica edhe per ata qe u shokuan, kur pane si vriteshin njerez te pafajshem ne pranine e prifterinjve ortodokse qe i bekonin dhe i miratonin keto vrasje qe beheshin ndaj ketyre krijesave njerezore qe fajsoheshin vetem se ishin muslimane. Ka kaluar me se nje deka dhe njerezit pyesin si u masakruan keto civile, qe ishin mbrenda nje perimetri qe ishte shpallur si zone sigurie nga OKB, ku ruanin trupat paqeruajtese holandeze. Por, faktet te reja vazhdojne te prezantohen ne media, te cilat tregojne se fije te panumurta gershetohen ne realizimin e planit per t'ua dorezuar Srebernicen serbeve, ku kontributi i ushtarve holandese per t'u bere pjese e masakres eshte liliput (I vogel). Ish zedhensja e Tribunalit te Hages, Florens Hartmans deklaroi se ne e dinim se ku ishin kriminelet qe masakruan muslimanet ne Bosnje, por arrestimet e tyre bllokoheshin here nga Shiraku, here nga Klintoni. Florens Hartmans deklaroi se flet ne baze te dokumenteve dhe deklaratave origjinale.

Ajo deklaroi se kriminelet Karaxhic dhe Mlladic nuk kane paraqitur problem per Serbine, ne se ishin arrestuar dhe derguar ne Hage. Ata te arrestuar dhe para trupit gjykues do te paraqitnin problem vetem per amerikanet dhe perendimoret, sepse do te dilnin ne publik marreveshtjet e fshehta qe sollen renien e Srebernice ne duart serbeve. Arrestimi dhe neses deklarimet ne gjyq te Karaxhicit do te jene shume te rrezikshme per Perendimin, i cili ka pjesen e vet te rendesishme per ate qe ndodhi ne vitin 1955 ne Srebernice. Punonjesja juridike e Gjykates se Hages deklaroi se i vetmi person qe mund te dije dhe mund te flase per marreveshtjet e fshehta ne mes te trupave serbe dhe te diplomateve dhe ushtarakeve perendimore ne dorezimin e Srebernice ne duart e serbeve, e cila u pasua me nje masaker qe eshte portretizuar si masakra me e ashpër pas Luftes se Dytë Botërore, eshte kriminelin Radovan Karaxhic te cilit, ata qe jane te interesuar qe ai te heshte, mund t'i kene pergaditur fatin qe provoi padroni i tij, Milloshevic, kur ishte ne Tribunalin e Hages per t'u gjykuar per krimet ne ish -Jugosllavi, ku vrasjet e civileve ne Srebernice dominonin akuzen kunder kasapit te Ballkanit. Kane kaluar pak dite, kur mediat nderkombetare dhane lajmin e rralles per gjetjen e nje varri masiv me kufomat e muslimaneve boshnjake prane qytetit te Srebernice, e cila tashme eshte kthyer ne nje miniere kufomash muslimane qe duket se nuk



do te shteroje kurre, sepse vetem ata qe e planifikuan masakren kunder muslimaneve dhe ata qe e zbatuan kete masaker, duhet ta njohin numurin e sakte te atyre burrave qe u vrane si qener vetem se ishin muslimane dhe si te tille ata ishin te padesherueshem si per planifikuesit e masakres, ashtu edhe per ekzekutuesit e masakres se atij qyteti qe quhet Srebernice, emri i se ciles eshte bere simbol i dhimbjes njerezore dhe njekohesisht akuze e ashpër kunder atyre qe i kane drejtuar grykat e armeve kunder muslimaneve ne te gjithë planetin, te cilet kerkon te bejne gjumin e qete vetem duke pergaditur Srebernicen te tjera qe do ta lene shume pas Srebernicen e Bosnjes per shkallen e krimit qe do te shohe bota ne gjakderdhjet qe po per-

gaditen sot kunder popujve muslimane, ku krimet kunder tyre po njohin nje spirale qe lartsohet pandërprerje, por qe ka shume mundesi qe neses te rrezohet dhe te zere poshte te gjithë ata qe planifikojne Srebernicen kunder muslimaneve. Dhe ate dite, kur ne Tribunalin e Hages do te dalin kriminelet e vertete, bota do te shohe si do te vendoset drejtësia ne vend. Pikerisht ate dite do te marre fund planifikimi i Srebernicave te reja dhe bota do te njohe paqen e vertete dhe jo paqen qe sjellin "trupat paqeruajtese" te armatosur deri ne dhembë dhe qe po masakrojnë pa meshire civile te pafajshem ne hapësira ku jetojnë popuj muslimane.

Materjali u pergadit nga Alban Kastrati

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
BISMIL-LAHIR-RAHMANIR-RAHIME

Tregtojme
**MISH
HALLALL**

E XHUMA
PUSHIM → BESNIK ALUSHI
ISMETI

Produkt Hallall

**KLIENTË TË NDERUAR!
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

- 1- Produkte mishi hallall si:
sallam, suxhuk etj.**
- 2- Piceri hallall**
- 3- Fast Food hallall**

**Ju keni të drejtë të blini ku të doni
por hallalli i vërtetë është vetëm
tek market "ISMETI"**

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENI"
Cel: 0692101893